

VENDIM
Nr.764, datë 14.11.2007

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2008, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, nenit 11 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për vitin 2008, në shumën 24 095 500 (njëzet e katër milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ENTI RREGULLATOR I UJIT

Pasqyra nr.1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2008

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Në lekë
1.	Shpenzime për paga	14 776 500
2.	Sigurime shoqërore	3 054 000
3.	Shërbime e furnitura	5 265 000
4.	Investime	1 000 000
	TOTALI	24 095 500